



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 90 date 20/12/2002

**PER
FINANCIMIN E PROJEKTIT "TË FESTOJME SE BASHKU VITIN E RI"**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e datës 20.12.2002 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, për financimin e projektit "Të festojmë së bashku Vitin e Ri", mbështetur në Ligjin Nr.8652 dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 10, pika 3 (paragrafi II/C), neni 72, pika 4 (paragrafi II/C) dhe neni 32, (gërma dh), Ligjin Nr.7776 dt.22.12.1993 "Për buxhetin lokal" ndryshuar me Ligjin Nr.8399 dt.09.09.1998 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr.7776 dt.22.12.1993 "Për buxhetin lokal", Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.4 dt.11.02.2002 "Për Miratimin e Buxhetit të vitit 2002" dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë

V E N D O S I

1. Të miratojë shumën prej 930.000 lekë për projektin "Të festojmë së bashku Vitin e Ri"
2. Kjo shumë të përballohet nga fondi i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.4 dt.11.02.2002 "Për Miratimin e Buxhetit të vitit 2002" për projekte sociale dhe arsimore

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar, për zbatimin e këtij vendimi
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

KRYETARI

Leonidha TOSKA

